



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 185/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Malishevë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Malishevë, për shkak të vendosjes së flamujve mbi rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Malishevë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 5300 (pesëmijetreqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 06.10.2013, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se me datën 06.10.2013, rreth orës 14:30, në rrugën Rilindja Kombëtare në Malishevë, si dhe tek rrethi i qytetit, anëtarë të subjektit politik të PDK-së, kanë vendosur flamuj të këtij subjekti mbi rrugë publike, ku me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës konsiderohet se është bërë shkelje e nenit 33 pika b) e LZP-së, dhe nenit 3 pika b) e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike.

Parashtruesi i ankesës si provë i ka bashkangjitur ankesës dy fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 07.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.10.2013. PZAP-i, brenda afatit të caktuar, pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së, janë të pabaza lidhur me shkeljen e Kodit të Mirësjelljes të Subjekteve Politike, respektivisht nenin 33 pika b, dhe neni 3 pika b e Kodit të Mirësjelljes për Subjekt Politik, si dhe pretendimet e deritanishme dhe dëshmitë e LVV-së, janë të natyrës së njëjtë, gjithashtu në ankesë theksohet se, asnjë veprim i tillë nuk është bërë nga aktivistet e PDK-së, dhe se për këto veprime nuk mbajmë përgjegjësi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Sipas pretendimeve ankimore, anëtarë të subjektit politik PDK, kanë vendosur flamuj të këtij subjekti mbi rrugë publike, i cili veprim është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP, nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që kanë të bëjnë me vendosjen e

njoftimeve, pllakateve, dhe posterëve ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me lidhje me fushatën zgjedhore, në apo mbi rrugë publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Nga dëshmi, fotografit e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës identifikohet çart se flamujt me logon subjektit politik PDK janë të vendosur mbi rrugë publike, një veprim të tillë PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat e sipërsëhënuara ligjore.

Pretendimet në përgjigjen e ankesës nga subjekti politik PDK se nuk mbajmë përgjegjësi lidhur me veprimet e tilla, janë të paqëndrueshme sepse në nenin 32.1.5 të LZP-së, parashihet se këtij kodi i detyrohen dhe janë përgjegjëse të gjitha subjektet politike. Në përgjigje të ankesës nuk është bashkangjitur asnjë dëshmi që kërkohet sipas nenit 32.6 të LZP-së se subjekti politik në fjalë ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar ose dekurajuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët nga shkelja e këtij Kodi.

Prandaj duke pasur parasysh se nga ana e subjektit politik PDK, është bërë shkelje e nenit 33 pika b) e LZP-së, neni 4.1 pika b), të Rr. Zgjedhore Nr. 11/2013, ngase janë vendosur flamuj me logon subjektit politik PDK mbi rrugë publike, po ashtu fakti se subjekti politik në fjalë nuk ka bërë asnjë përpjekje serioze për të parandaluar veprimet e tilla, me qëllim të evitimit të shkeljeve të sipërsëhënuara, po ashtu subjekti i njëjtë politik ka bërë shkelje të kësaj natyre edhe më herët në këto zgjedhje dhe konsiderohet se i ka përsëritur shkeljet e tilla të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre të cilën PZAP, e mori si rrethanë rënduese për rritjen e dënimit, si dhe duke marrë parasysh faktorët e cituar me lartë, për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

Anr. 185/2013 më datën 09.10.2013.



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*